

LIGJ
Nr. 86/2025

**PËR FSHIRJEN, SHUARJEN DHE PAGESËN E DETYRIMEVE TATIMORE NDAJ
ADMINISTRATËS TATIMORE QENDRORE E VENDORE DHE E DETYRIMEVE
TË PAGUESHME NË DOGANË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Objekti

Ky ligj parashikon kushtet për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore të papaguara ndaj administratës tatimore qendrore në sistemin tatimor “*e-tax*” ose jashtë tij, administratës tatimore vendore, si dhe të detyrimeve të pagueshme në doganë.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Detyrime tatimore të papaguara” janë tatimi/kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore/taksa/tarifa, kamatëvonesa dhe çdo dënim administrativ, i lidhur ose jo me një lloj tatimi/ takse/tarife/kontributi, sipas ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ose ligjeve të tjera tatimore, nga administrata tatimore qendrore dhe administrata tatimore vendore;
2. “Detyrime të pagueshme në doganë” janë detyrime të papaguara që kanë subjektet ndaj autoritetit doganor, përkatësisht, taksa doganore, TVSH-ja, akciza, taksat kombëtare, që mbliidhen nga dogana në rolin e agentit tatimor, gjoba dhe kamatëvonesa.
3. “Subjekt” është personi fizik, personi juridik, si dhe çdo person tjetër/individ me zotësi të plotë për të vepruar, të njohur si subjekte nga legjislacioni në fuqi;
4. “Tatimpagues” është sipas përkufizimit në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Me termin tatimpagues sipas ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, kuptohet edhe individi i paregjistruar me NIPT/NUIS.
5. “Detyrime tatimore të evidentuara në llogarinë e tatimpaguesit” janë dënimet administrative të konstatuara nëpërmjet aktkonstatimit deri në datën 31.12.2024.
6. “Detyrime tatimore të regjistruara në llogarinë e tatimpaguesit” janë detyrime të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi apo të vlerësuara nga administrata tatimore ose të gjeneruara nga sistemi, të cilat janë kontabilizuar deri në datën 31.12.2024.

Neni 3
Tatimpaguesit/subjektet përfituese

Nga përcaktimet e parashikuara në këtë ligj përfitojnë:

- a) tatimpaguesit e regjistruar në regjistrin aktiv, pasiv, të çregjistruar ose me statuse të tjera në sistemin tatimor “*e-tax*” për detyrime tatimore ndaj administratës tatimore qendrore, sipas neneve 5, 6, 7 dhe 11 të këtij ligji;

b) subjektet e regjistruara në regjistrin aktiv, pasiv ose të çregjistruar për detyrime tatimore ndaj administratës tatimore vendore, sipas neneve 5, 6, 7 dhe 11 të këtij ligji;

c) subjektet debitore ndaj administratës doganore për detyrime, sipas neneve 9, 10 dhe 11 të këtij ligji;

ç) brenda datës 31.01.2027 organet përkatëse publikojnë në faqen zyrtare *web* të institucionit, listën e plotë të 3000 (tre) mijë tatimpaguesve/subjekteve që kanë rezultuar me fshirjen/shuarjen më të madhe të detyrimeve sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në çdo rast, në listë të përfshihen të gjithë tatimpaguesit/ subjektet, të cilave u është fshirë/shuar detyrimi jo më i vogël se 5 milionë lekë.

Neni 4

Tatimpaguesit/subjektet që nuk përfitojnë

1. Nga fshirja/shuarja e detyrimeve të parashikuara, sipas këtij ligji, nuk përfitojnë tatimpaguesit/subjektet që kanë detyrime tatimore/detyrime të pagueshme në doganë, të cilët/të cilat janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose janë në proces gjyqësor apo hetimi për vepra penale në fushën tatimore dhe/ose doganore, në kuptim të legjislacionit të fushës, përpara ose gjatë kohëzgjatjes së zbatimit të këtij ligji.

2. Informacioni sipas pikës 1 të këtij neni sigurohet nga organet e pushtetit gjyqësor, nga Ministria e Drejtësisë dhe/ose institucionet në varësi të saj apo nga organet e pavarura të drejtësisë.

Neni 5

Fshirja e detyrimeve tatimore të papaguara

1. Fshihen plotësisht detyrimet tatimore të papaguara, që u përkasin periudhave tatimore deri në datën 31 dhjetor 2014, të cilat rezultojnë të llogaritura apo të regjistruara në llogaritë tatimore të tatimpaguesve apo të regjistruara në kontabilitetin e administratës tatimore, përveç kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

2. Fshihen/shuhen detyrimet e papaguara, të përcaktuara sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, që u përkasin periudhave tatimore deri në datën 31 dhjetor 2014.

3. Shuhen dënimet administrative (gjobat dhe kamatëvonesat) për sigurimet shoqërore e shëndetësore, që u përkasin periudhave tatimore deri në datën 31 dhjetor 2014, që rezultojnë të llogaritura apo të regjistruara në llogarinë e tatimpaguesit, përfshirë të vetëpunësuarit në bujqësi, por pa përfshirë kontributin.

4. Pavarësisht nga përcaktimet në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, në rastin kur është paguar principi dhe tatimpaguesi ka detyrime të papaguara vetëm gjoba dhe kamatëvonesa në llogarinë e tij, falen gjobat dhe kamatëvonesat.

5. Detyrimet tatimore të papaguara, të vendosura për subjektet e çregjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit pas datës së çregjistrimit, të evidentuara dhe të kontabilizuara në regjistrat e administratës tatimore deri në datën 31.12.2024 fshihen.

Neni 6

Shuarja pjesore e detyrimeve tatimore, me kusht pagimin e tatimit/taksës/tarifës/kontributit

1. Për detyrimet tatimore, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që u përkasin periudhave tatimore nga 1 janari 2015 deri më 31 dhjetor 2019:

a) shuhet 50% e detyrimit tatimor nëse pjesa e mbetur 50% e tatimit/taksës/tarifës paguhet e gjitha njëherësh brenda datës 30.6.2026;

b) shuhet 25% e detyrimit tatimor nëse pjesa e mbetur 75% e tatimit/taksës/tarifës paguhet brenda datës 31.12.2026.

Në të dyja rastet, sipas shkronjave “a” e “b” të kësaj pike, gjobat dhe kamatëvonesat për periudhat përkatëse fshihen plotësisht.

2. Për taksat/tarifat vendore të papaguara që u përkasin periudhave tatimore nga 1 janari 2015 deri më 31 dhjetor 2019:

a) shuhet 50% e taksës/tarifës vendore nëse pjesa e mbetur 50% e taksës/tarifës paguhet e gjitha njëherësh brenda datës 30.6.2026;

b) shuhet 25% e taksës/tarifës vendore nëse pjesa e mbetur 75% e taksës/tarifës paguhet brenda datës 31.12.2026.

Në të dyja rastet, sipas shkronjave “a” e “b” të kësaj pike, gjobat dhe kamatëvonesat për periudhat përkatëse fshihen plotësisht.

3. Pavarësisht nga përcaktimet në pikën 1 të këtij neni, në rastin kur është paguar principi dhe tatimpaguesi ka detyrime të papaguara vetëm gjoba dhe kamatëvonesa në llogarinë e tij, falen gjobat dhe kamatëvonesat.

4. Shuhen gjobat dhe kamatëvonesat për detyrimet që u përkasin periudhave tatimore nga data 1 janar 2020 deri në datën 31 dhjetor 2024, me kusht që tatimi/taksa/tarifa për periudhën përkatëse të paguhet brenda datës 31.12.2026.

5. Shuhen dënimet administrative (gjobat dhe kamatëvonesat) për sigurimet shoqërore e shëndetësore, që u përkasin periudhave tatimore nga data 1 janar 2015 deri në datën 31 dhjetor 2024, që rezultojnë të llogaritura apo të regjistruara në llogarinë e tatimpaguesit, përfshirë të vetëpunësuarit në bujqësi, me kushtin që të paguhet 100% kontributi brenda datës 31.12.2026.

Neni 7

Fshirja/shuarja e detyrimeve tatimore të tjera

Janë, gjithashtu, objekt i fshirjes/shuarjes, sipas këtij ligji, detyrimet tatimore të mëposhtme, pavarësisht periudhës tatimore së cilës i përkasin:

a) detyrimet tatimore të tilla, si: tatimi/taksa/tarifa/kamatëvonesa dhe dënimet administrative për tatimpaguesit, persona fizikë ose juridikë që rezultojnë të çregjistruar në QKB ose me vendim gjykatë apo që janë të çregjistruar në administratën tatimore deri në datën 31.12.2024;

b) dënimet administrative (gjobat) tatimore të llogaritura automatikisht nga sistemi për mosdeklarim në afat, sipas nenit 113, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, deri në datën 31.12.2024, përfshirë edhe dënimet që lidhen me afatin e deklarimit të të punësuarve;

c) dënimet administrative (gjobat) për mosdeklarim në afat për deklarata të padorëzuara, që u përkasin periudhave deri në datën 31.12.2024, me kusht që çdo deklaratë e padorëzuar të dorëzohet deri në datën 30.6.2026;

ç) dënimet administrative (gjobat) për dorëzim të vonuar të vendimit për destinimin e rezultatit dhe dorëzim me vonësë të pasqyrave financiare të aplikuara, sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, të llogaritura deri në datën 31.12.2024;

d) gjobat dhe interesat e gjeneruara në sistem nga ndryshimi i listëpagesave për periudhat e kaluara, që rrjedhin nga zbatimi i një akti ligjor apo nënligjor me efekt prapaveprues apo zbatimit të një vendimi gjykatë të formës së prerë.

Neni 8

Kompensimi i detyrimeve debitoare me tepricën kreditore të TVSH-së dhe gjendjen kreditore të tatimeve të tjera

1. Tatimpaguesit, që kanë tepricë kreditore të TVSH-së ose të një tatimi tjetër, përfitojnë nga fshirja/ shuarja e detyrimeve tatimore sipas neneve 5, 6, 7 dhe 11 të këtij ligji, pas kompensimit (zvogëlimit) të tepricës deri në masën e tatimit të papaguar.

2. Në rastet kur teprica nuk mbulon vlerën e plotë të tatimit të papaguar, atëherë duhet të kryhet pagesa për pjesën e mbetur pas kompensimit, sipas nenit 6 të këtij ligji, dhe më pas bëhet fshirja/shuarja e kamatëvonesave dhe dënimeve administrative.

3. Përcaktimet e këtij neni për kompensimin zbatohen automatikisht, pa kontroll, përveç rasteve të parashikuara në pikën 2, të nenit 11 të këtij ligji, për të cilat ky nen zbatohet kur tatimpaguesi heq dorë nga ankimi administrativ ose nga e drejta e padisë/ankimit/rekursit në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit pranë gjykatës kompetente.

4. Në zbatim të këtij ligji, kompensimit do t'i nënshtrohen të gjitha detyrimet tatimore të papaguara, përfshirë tatimin mbi të ardhurat nga punësimi (TAP), me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Neni 9

Fshirja e detyrimeve të pagueshme në doganë

Fshihen nga regjistrat detyrimet e pagueshme në doganë, sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2 të këtij ligji, të lindura ndaj administratës tatimore/doganore deri në datën 31.12.2014, të evidentuara në evidencat kontabël të borxhit të kësaj administrate. Fshihen gjobot dhe kamatëvonesat kur subjekti është debitor vetëm për të tilla detyrime të lindura ndaj administratës tatimore/doganore deri në datën 31.12.2014.

Neni 10

Pagesa e detyrimit dhe shuarja me kusht e detyrimeve të pagueshme në doganë

1. Për detyrimet e pagueshme në doganë, të evidentuara nëpërmjet vendimeve të kësaj administrate, nga data 1.1.2015 deri në datën 31.12.2019:

a) shuhen në masën 50% të taksës doganore, TVSH-së, akcizës, taksave kombëtare, që paguhen ose mblidhen nga administrata doganore në rolin e agjentit tatimor, nëse pjesa e mbetur 50% e tyre paguhet e gjitha njëherësh brenda datës 30.6.2026;

b) shuhen në masën 25% të taksës doganore, TVSH-së, akcizës, taksave kombëtare, që paguhen ose mblidhen nga administrata doganore në rolin e agjentit tatimor, nëse pjesa e mbetur 75% e tyre paguhet brenda datës 31.12.2026.

Në të dyja rastet, sipas shkronjave “a” e “b” të kësaj pike, gjobot dhe kamatëvonesat për periudhat përkatëse fshihen plotësisht.

2. Pavarësisht nga përcaktimet në pikën 1 të këtij neni, në rastin kur është paguar principi dhe subjekti ka detyrime të papaguara vetëm gjoba dhe kamatëvonesa në llogarinë e tij, falen gjobot dhe kamatëvonesat.

3. Shuhen gjobot dhe kamatëvonesat për detyrimet e pagueshme në doganë, që i përkasin periudhës nga data 1.1.2020 deri më 31.12.2024, me kusht që detyrimi për periudhën përkatëse të paguhet i plotë brenda datës 31.12.2026.

4. Fshihen të gjitha detyrimet e mbetura pa paguar deri në vlerën 1 500 lekë për subjektet që nuk kanë detyrime të tjera.

5. Fshihen të gjitha detyrimet e individëve debitorë për të cilët nuk ka informacion për numrin e identifikimit (ID), nuk është bërë njoftimi për detyrimin për mungesë identifikimi dhe nuk ka vendim për rikuperim me forcë të borxhit, përfshirë këtu edhe individët që kanë zhdoganuar automjete me NIPT-in/NUIS-in e përgjithshëm A000000A.

Neni 11

Detyrimet tatimore dhe detyrimet e pagueshme në doganë që janë në proces ankimi

1. Nga fshirja/shuarja e detyrimeve të parashikuara, sipas këtij ligji, nuk përfitojnë tatimpaguesit/subjektet që kanë detyrime tatimore/detyrime të pagueshme në doganë, për të cilët ka vendim

gjyqësor të formës së prerë për këto detyrime me palë fituese administratën doganore/tatimore, në kuptim të legjislacionit të fushës.

2. Tatimpaguesit/subjektet, me përjashtim të atyre të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, i cili/të cilat është/janë në proces ankimi administrativ ose gjyqësor për detyrimet tatimore/detyrimet e pagueshme në doganë, i nënshtrohen këtij ligji, nëse ai heq dorë nga ankimi administrativ ose nga e drejta e padisë/ankimit/rekursit në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit pranë gjykatës administrative kompetente.

3. Administrata tatimore ose doganore, për detyrimet që fshihen/shuhën, sipas këtij ligji, në rastin kur i ka filluar, ndërpret procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve. Për detyrimet tatimore ose detyrimet e pagueshme në doganë, që nuk përfitojnë nga fshirja/shuarja, sipas këtij ligji, procedurat e mbledhjes së detyrimeve vijojnë të kryhen sipas përcaktimeve në legjislacionet përkatëse.

Neni 12

Afati i zbatimit dhe e drejta e ankimit

1. E drejta e tatimpaguesve/subjekteve, që përfitojnë nga dispozitat e këtij ligji, ushtrohet brenda afateve të përcaktuara në nenet përkatëse.

2. Tatimpaguesit/subjektet për të cilat shuarja e detyrimit aplikohet me kusht, nuk përfitojnë shuarje të detyrimit, nëse nuk përmbushin kushtet brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj.

3. Për çdo tatimpagues/subjekt, që përfiton ose jo nga fshirja/shuarja e detyrimeve, organi përkatës nxjerr një akt administrativ për këtë qëllim brenda afatit të zbatimit të këtij ligji, duke njoftuar edhe tatimpaguesin.

4. Tatimpaguesit/subjektet, të cilët/të cilat sipas një vendimi të administratave përkatëse nuk përfitojnë nga fshirja/shuarja sipas këtij ligji, kanë të drejtë të ankohen në gjykatën administrative, sipas legjislacionit të fushës në fuqi.

Neni 13

Organet zbatuese dhe afati për fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore e të detyrimeve të pagueshme në doganë

1. Brenda datës 31.12.2026 organet përkatëse fshijnë/shuajnë nga regjistrat e tyre kontabël dhe nga llogaria e tatimpaguesit debitor detyrimet që fshihen/shuhën sipas këtij ligji.

2. Ky ligj i shtrin efektet nga data 1 janar 2026 deri në datën 31.12.2026.

3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, njësitë e qeverisjes vendore dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 14

Nxjerrja e akteve nënligjore

Brenda 15 ditëve nga hyja në fuqi e këtij ligji ministri përgjegjës për financat nxjerr udhëzim për zbatimin e tij.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 12.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 22, datë 12.1.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.